



## DualAFS - Programi i studimeve të integruara me punë praktike në bujqësi dhe sigurinë ushqimore

<b>Programi i BE-së:</b>	Erasmus +
<b>Nënprogrami:</b>	Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira
<b>Masa KA2:</b>	Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e lartë
<b>Kohëzgjatja:</b>	(CBHE) 15.01.2021 - 14.01.2024

E-Newsletter Numër 4, Mars 2023

### Studimi bazë – Nevoja për aftësim dhe mbështetje në bujqësi dhe sigurinë ushqimore në Shqipëri & Kosovë

**Veshtrim i përgjithshëm:** Për hartimin e një programi Dual, duhet të zhvillohen të gjitha çështjet që lidhen me bashkëpunimin midis universitetit dhe Partnerëve të Jetës së Punës (WLP), pasi një program Dual nënkupton një kombinim të teorisë së auditorit dhe praktikës së bazuar në kompani.

Për të riorganizuar programet aktuale të studimit, niveli bachelor në zootekni dhe agrobiznes në formën e dyfishtë, u krye një studim empirik me metodën sasiore duke përdorur pyetësorë të strukturuar. Në Shqipëri dhe Kosovë u identifikuan tre grupe të interesit: fermat, institucionet publike agroushqimore dhe grupet akademike. Pyetësorët u fokusuan në aftësitë e kërkuara të të diplomuarve dhe në bashkëpunimin mes universitetit dhe WLP në zbatimin e programit të studimit të dyfishtë në bujqësi. Pyetësorët u ofruan online duke përdorur programin Webropol 3.0. Janë kthyer gjithsej 919 pyetësorë të plotësuar; të vlefshme: 150 nga kompanitë, 144 nga institucionet publike dhe 267 nga studentë/staf akademik të programeve përkatëse të katër universiteteve në të dy vendet. Të dhënat janë analizuar statistikisht duke përdorur programin Webropol 3.0.

Rezultatet e këtij sondazhi tregojnë se të gjitha grupet e interesit, veçanërisht WLP-ja, i kushtojnë rëndësi të madhe fillimisht trajnimit praktik dhe më pas aftësive të TI-së, komunikimit dhe biznesit të të diplomuarve. Gjithashtu, të gjitha WLP-të deklarojnë vullnetin e tyre për të marrë pjesë në zbatimin e studimeve të dyfishta së bashku me universitetet. Për këtë, WLP-të kërkojnë mbështetjen nga shteti në formën e stimuljeve të ndryshëm, si dhe rregullore të qarta ligjore.

## DualAFS – Aktivitete për përhapje informacioni

**Kongresi Botëror ISAE 2022.** Përfaqësuesit (Skender Muji dhe Alltane Kryeziu) e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, marrin pjesë në Kongresin Botëror ISAE 2022, të mbajtur në Ohër, Maqedoni të Veriut. Në këtë Kongres u prezantuan qëllimi dhe të arritura e Projektit DualAFS, të financuar nga Komisioni i Bashkimit Evropian.



Gjatë prezantimit të posterit me titull “Initiation of University dual study programs in field of animal sciences in Albania and Kosovo (Erasmus+ DualAFS)“, pati diskutime të shumta me përfaqësues të universiteteve të ndryshme në rajon dhe më gjerë, rreth statusit, vlerës dhe atributit të Dual Curriculës.

- Konferenca e parë ndërkombëtare mbi “Rininë Rurale dhe Garantimin e Rinisë” zhvilluar në Brescia (Itali).



**Konferenca e parë ndërkombëtare mbi “Rininë Rurale dhe Garantimin e Brezit të Ri** Përfaqësues të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, morën pjesë në Konferencën e parë ndërkombëtare mbi “Rininë Rurale dhe Garantimin e Brezit të Ri” Zhvilluar në Brescia (Itali), me prezantimin “Tendencat e zhvillimit të sektorit bujqësor në Shqipëri: Perspektiva për rininë rurale”. Në këtë aktivitet u prezantuan rezultatet e pyetësorit bazë që u përgatit në kuadër të projektit DualAFS. Link-u i punimeve të prezantuara gjatë konferencës: <https://rnyobservatory.eu/web/wp-content/uploads/2023/03/Brescia23-Proceeding.pdf>.

**BE për Ditët e Rinisë.** BE më datat 11 dhe 12 tetor 2022 organizoi ditët e rinisë, ku u zhvilluan një sërë ngjarjesh të orientuara drejt rinisë të quajtura “BE për Ditët e Rinisë”. Projekti DualAFS u zgjodh të paraqitet në një stendë të veçantë në Dhomën e Europës. Aktiviteti u çel nga Ambasadorja e BE, Znj. Christine Hohmann, e cila së bashku me delegacionin vizitoi të gjithë stendat e pjesëmarrësve. Në aktivitet morën pjesë gjithashtu nxënës të shkollave të mesme, studentë të universiteteve, të rinj profesionistë të cilët paten mundësinë të vizitonin stendat dhe të bashkëbisedonin me të gjithë pjesëmarrësit. Aktiviteti u organizua në katër sesione informuese (i) studimet në Bashkimin Evropian, (ii) lëvizshmëria dhe programet e shkëmbimit, (ii) Kërkim, inovacion, programet e asistencës së BE-së për studime novatore; (iii) punësimi I të rinjve, përfshirja



sociale, pjesëmarrja dhe mundësitë e barabarta, (iv) njohja me persona pas vitit European për Rininë & Tirana-Kryeqyteti për rininë europiane.

Në veprimtarinë e zhvilluar morën pjesë, Prof. Lumturi Papa, Prof. Anila Hoda, Prof. Enkelejda Sallaku të cilat informuan të interesuarit mbi programet e studimit të riorganizuar në kuadër të këtij projekti, mundësitë e formimit teorik dhe sidomos praktik të të rinjve, si dhe për mundësitë e punësimit. Informacioni u bë i njohur jo vetëm përmes posterit të DualAFS, por edhe përmes prezantimit në PPT, ku pjesëmarrësit u njohën me partnerët e projektit, investimet e bëra drejt krijimit të klasave hibride dhe përmirësimit të laboratorëve mësimorë në UBT falë mbështetjes të projektit DualAFS, financuar me fondet e BE në kuadër të programit Erasmus Plus, “Ngritje e Kapaciteteve”. Pjesëmarrësit u njohën me trainimet e bëra nga Hannu Vitala për përdorimin e teknikave dhe mjeteve të të mësuarit elektronik dhe në distance, si një nevojë e kohës, tashmë një realitet në UBT. Të rinjtë e interesuar u informuan dhe për mundësitë e formimit praktik,

përmes “*learning by doing*” që ofrojnë programet tona të studimit, si dhe në mënyrë të veçantë për mundësinë e kryerje së studimeve nga ana e tyre për një semester në Universitetin SAVONIA, të shkencave të aplikuara, Finlandë.

Ambasadoria e BE, Znj. Christine Hohmann, gjatë ndalesës në stendën e DualAFS, vlerësoi investimin në drejtim të edukimit të të rinjve, konkretisht në shkencat bujqësore, orientimin e tyre sipas nevojave të tregut të punës dhe veçanërisht përdorimin e metodave të të mësuarit në distance, si dhe theksoi kohën e bujqësisë digitale..



## DualAFS TAKIMI I KOMITETIT DREJTUES NË KORÇË, SHQIPËRI

Gjatë periudhës 26.09.2022 dhe 01.10.2022 partnerët e projektit DualAFS u takuan dhe morën pjesë në workshop-in dhe takimin e komitetit drejtues të projektit, në Universitetin Fan S. Noli, Korçë. Vëmendje iu kushtua përvojave të shkëmbimeve të stafit akademik midis universiteteve shqiptare dhe



kosovare dhe universiteteve partnere të BE-së. Deri tani, një total prej 10 mësuesish nga universitetet në Tiranë, Korçë, Prishtinë dhe Mitrovicë kanë marrë pjesë në shkëmbimet e financuara nga projekti..

Gjatë lëvizshmërisë së tij, specialisti i e-learning Hannu Viitala nga Universiteti Savonia i Shkencave të Aplikuara trainoi stafin akademik të universiteteve në Shqipëri dhe Kosovë, mbi përdorimin e pajisjeve e-learning dhe metodave të mësimdhënies. Disa nga universitetet e përfshira në këtë projekt janë të paisura me pajisje të të mësuarit elektronik dhe ajo që është mësuar në teori u aplikua direct në praktikë (Ju mund të lexoni më shumë mbi eksperiencën e Hannu Vitala në një postim të veçantë në zërin “Lajme dhe Aktivitete”



Në një diskutim në një tavolinë të rumbullakët në 28 Shtator 2022, në të cilën morën pjesë grupe të ndryshme interesi, u mundësua adresimi i nevojës së studimeve të orientuara drejt praktikës, si dhe bashkëpunimi i ngushtë midis partnerëve të universiteteve dhe të partnerëve nga sektori i tregut të punës. Pjesëmarrësit shprehën interesin e tyre për punonjës të kualifikuar në sektorin e bujqësisë. Në tërësi, objektivat e projektit DualAFS u mirëpritën nga



pjesëmarrësit dhe u shpreh gatishmëria e partnerëve të praktikës për të marrë pjesë në zbatimin e pjesës praktike nga ana e studentëve..

Përveç kësaj, konsorciumi mori pjesë në disa aktivitete të ndryshme, midis të tjerave, Qendrën për Transferimin e Teknologjive Bujqësore, Korçë (27.09.2022), fabrikën e birrës Korçë (28.09.2022) dhe gjithashtu vlen të përmendet dhe një edukim kulturor i pjesëmarrësve përmes një udhëtimi studimi në Voskopoje (30.09.2022).

## DualAFS Mobilitete – të mësuarit dhe të mësuarit me mjete dhe rrugë elektronike

Qëllimi i programit të edukimit dhe trajnimit është zhvillimi i përdorimit nga pjesëmarrësit të mjeteve dixhitale në mësimdhënie dhe rritja e nivelit të eLearning në universitetet pjesëmarrëse..




Hannu Vitala organizoi trajnime dhe mbajta seminare në katër universitete partnere të DualAFS: Prishtina UNI-PR dhe Mitrovica UIBM në Kosovë, Tirana AUT dhe Korca UNIKO në Shqipëri.

Në seminare u diskutua mbi mundësitë që ofron mësimi

online për zhvillimin e arsimit të lartë. Nëpërmjet ushtrimeve praktike, pjesëmarrësit njohën një gamë të gjerë mjesh të ndryshme të mësimdhënies online. Atmosfera dhe mësimi hibrid ishin në qendër të vëmendjes së veçantë. Dy universitete kanë fituar tashmë të paktën një klasë hibride në kuadër të projektit dhe universitete të tjera po planifikojnë ta krijojnë një të tillë. Gjatë seminareve u demonstrua përdorimi i klasës hibride.

Përmbajtja e seminareve ishte e ngjashme në të gjitha universitetet, edhe pse ishte gjithashtu e mundur të merrte pjesë në seminare në distancë. Lidhja e rrjetit nuk funksionoi normalisht në të gjitha universitetet. Përveç kësaj, qëllimi ishte të takoheshin pjesëmarrësit ballë për ballë, në mënyrë që në të ardhmen puna të ishte më efektive edhe në distancë.

Prezantimet e learning nxitën shumë diskutime dhe ushtrimet praktike i frymëzuan pjesëmarrësit të provonin mjetet e mësimdhënies online edhe në mësimdhënien e tyre, bazuar në feedback-un e marrë.



Në total morën pjesë në **seminarët e learning rreth 60 pjesëmarrës**, nga të cilët 39 përfunduan gjithashtu stërvitjet e përfshira në seminare. Kështu që kishte një mesatare prej dhjetë pjesëmarrës aktivë për universitet.

Në seminare morën pjesë pjesëmarrës nga disa fakultete të ndryshme, ndonjëse partnerët e DualAFS përfaqësojnë shkencën e ushqimit apo bujqësinë.

Trajnimi eLearning vazhdon në OpenEdu-Moodle dhe Zoom përmes **seminareve mujore**, qëllimi i të cilëve është të japin ide për përdorimin e mjeteve të mësimin online në mësimin e vetë pjesëmarrësve, si dhe për të praktikuar përdorimin e tyre.

## Partnerët e projektit dhe kontaktet

<b>Universiteti Nuertingen-Geislingen, Gjermani</b>	Prof. Dr. Heinrich Schuele	<a href="mailto:heinrich.schuele@hfwu.de">heinrich.schuele@hfwu.de</a>
<b>Savonia, Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Finlandë</b>	Dr. Ardita Jahja-Hoxha	<a href="mailto:Ardita.hoxha-jahja@savonia.fi">Ardita.hoxha-jahja@savonia.fi</a>
<b>Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri</b>	Prof. Dr. Anila Hoda	<a href="mailto:ahoda@ubt.edu.al">ahoda@ubt.edu.al</a>
<b>Universiteti "Fan Noli" Korçë, Shqipëri</b>	Prof. Dr. Gjergji Mero	<a href="mailto:gmero@unkorce.edu.al">gmero@unkorce.edu.al</a>
<b>Universiteti i Prishtinës,</b>	Prof. Dr. Skender Muji	<a href="mailto:skender.muji@uni-pr.edu">skender.muji@uni-pr.edu</a>

<b>Kosovë</b>		
<b>Universiteti “Isa Boletini” i Mitrovicës, Kosovë</b>	Dr. Arber Hyseni	<a href="mailto:bahtir.hyseni@umib.net">bahtir.hyseni@umib.net</a>
<b>Qendra e Zhvillimit Blegtoral dhe Rural, Shqipëri</b>	Prof. Dr. Gori Stefi	<a href="mailto:gori.stefi@gmail.com">gori.stefi@gmail.com</a>
<b>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Kosovë</b>	Kujtim Uka	<a href="mailto:kujtim.uka@rks-gov.net">kujtim.uka@rks-gov.net</a>
<b>Shoqata e Prodhuesve të Qumështit, Kosovë</b>	Gente Kadriu	<a href="mailto:kadriugenta@gmail.com">kadriugenta@gmail.com</a>
<b>Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, Shqipëri</b>	Eleni Elefteriu	
<b>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri</b>	Dr. Xhiliola Bixheku	<a href="mailto:xhiliola.bixheku@ascal.al">xhiliola.bixheku@ascal.al</a>
<b>Shoqata AGRINET, Shqipëri</b>	Tomi Pikuli	<a href="mailto:tomi_pikuli@yahoo.com">tomi_pikuli@yahoo.com</a>
<b>Nucleus Shqipëri</b>	Valbona Paluka	<a href="mailto:valbona.paluka@nucleus.al">valbona.paluka@nucleus.al</a>

#### Text & Layout

Myqerem Tafaj and Anila Hoda,  
Agricultural University of Tirana

Johannes Munz, Nuertingen-  
Geislingen University

© 2020-2024, DualAFS.

All rights reserved.

#### Pictures

© Nuertingen-GeislingenUniversity,  
Germany

© Agricultural University of Tirana

© University Fan Noli, Korca

© Universiteti i Prishtines “Hasan Prishtina”  
Kosova